



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

### I DETYRUAR

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

**Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi**

**Shkollat e mesme pedagogjike  
(kurrikula e vjetër)**

***Udhëzime të përgjithshme:***

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

## PJESA II

Balzak

*Evgjeni Grande (fragment)*

Pyetja 15	B	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	C	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë

---

### Pyetja 21 4 pikë

#### Model përgjigjeje

- Plaku është në prag të vdekjes. Por edhe në këto çaste ai mbetet makut. As vdekja nuk e ndryshon dot. Theksohen vazhdimisht sytë e plakut dhe duart e tij. Janë të vetmet që gjallojnë në atë trup që po vdes. Është po ai njeri, me po ato vese, me po atë portret. Ka po ata sy lakmitarë, po ato duar që përpiqen të kapin dhe rrëmbejnë gjithçka, ka po atë padurim të të pasurit dhe zotëruarit.

#### Ilustrime:

- duke kullotur sytë mbi verdhushkat,
- ai shtriu, i babëzitur e i llahtarshëm, dorën që ta kapë;
- sytë e bablokut ...u ringjallën
- M'i sill këtu para syve të mi!
- Kyçe këtë derë se mos më vjedhin!

**2 pikë** Nëse tregon qartë thelbin e portretit të Grandesë.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon **pjesërisht** portretin e Grandesë.

**2 pikë** Nëse gjen **dy** shprehje nga fragmenti që japin thelbin e portretit.

**DHE**

**1 pikë** Nëse gjen **një** shprehje nga fragmenti që jep thelbin e portretit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---

### Pyetja 22 3 pikë

**1 pikë** Edhe në çastet e tij të fundit, plaku mbetet i lidhur me dashurinë e vetme të tij, paranë (para tavolinës ku shtrohet ari). Ndërkohë që Evgjenia i thotë “baba”, ai asnjëherë nuk i thotë “bijë”. Ajo i kërkon uratën, ai në mënyrë cinike e kërcënon.

**1 pikë** Jo nuk ka ndryshuar. Grandeja është po ai që ka qenë diku, ka po atë autoritet, po atë imponim, po atë hije të rëndë.

**1 pikë** Për Grandenë rruga për tek e bija kalon nëpërmjet parasë, prandaj qëndrimi i tij nuk ndryshon.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

## Pyetja 23                    2 pikë

### Model përgjigjeje

- Plakun nuk e trondit aspak vdekja. Vdekja e vërtetë për plakun Grande është ndarja nga paratë. Për Grandenë paraja është sinonimi i jetës, lumturisë njerëzore, i vdekjes.

**2 pikë**                    Nëse sqaron **plotësisht** thelbin e këtij raporti.

**DHE**

**1 pikë**                    Nëse sqaron **pjesërisht** thelbin e këtij raporti.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

## Pyetja 24                    4 pikë

### Model përgjigjeje

- Dramaciteti buron nga fakti se Grandeja nuk shqetësohet se po vdes, por se po ndahet nga pasuria, nuk e shqetëson vajza që po lë vetëm, por ka hallin e mallit të tij. Nuk i bën përshtypje asnjë përkujdesje. Gjithçka ndodh në një kontrast bardh e zi. Në një anë Evgjenia me përkujdesjen e saj dhe në anën tjetër Grandeja i ftohtë dhe autoritar që mendon vetëm për paratë. Kjo makutëri dhe ky pasion i pandryshuar i tij nga asgjë, kjo mungesë e ndjenjave njerëzore sjell dhe dramacitetin në këtë fragment. Ideja e autorit shfaqet nëpërmjet fjalive, gjesteve, mimikës së personazhit. Këto realizohen përmes **detajeve artistike** si:  
*vatër, zjarr, fytyra që shkëlqen nga drita e lumturisë, sytë e bablokut, kryqi, vazoja, shandanët, nishani, dora.*  
**fjalive pyetëse, foljeve në urdhërore etj.**

**2 pikë**                    Nëse shpjegon qartë nga buron dramaciteti.

**DHE**

**1 pikë**                    Nëse shpjegon pjesërisht nga buron dramaciteti

**2 pikë**                    Nëse gjen dy detaje që shprehin këtë dramacitet.

**DHE**

**1 pikë**                    Nëse gjen një detaj që shpreh këtë dramacitet.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

